



Informacione për prindërit mbi kopshtin e fëmijëve

Me hyrjen në kopsht për fëmijën Tuaj fillon cikli i shkollimit në shkollën publike. Në këtë fazë të parë fëmijët përkrahen në mënyra të ndryshme, nxiten dhe përgatiten për hyrje në ciklin e ulët të shkollës fillore. Në këtë broshurë gjeni informacione mbi qëllimet, detyrat dhe organizimin e kopshtit të fëmijëve.

Qëllimet e kopshtit të fëmijëve

Me hyrjen në kopsht të fëmijëve të gjitha nxënëset dhe nxënësit janë rregullisht për disa orë të ndarë nga prindërit e tyre apo të autorizuarit e tyre për edukim. Me këtë atyre ju hapet një hapësirë e re jetësore, e lojës dhe e përjetimeve

Dijet, mundësitë, zhvillimi dhe parakushtet gjuhësore janë të ndryshme me hyrjen e fëmijëve në kopsht. Qëllimi është që të nxitet dhe të përkrahet zhvillimi individual dhe të mësuarit e çdo nxënëseje dhe nxënësi. Çdo fëmijë do të duhej t'i mundësohej ta shpaloste siç është më se miri potencialin e tij.

Çka do të thotë «të mësosh» në kopshtin e fëmijëve?

Kopshti i fëmijëve, shkolla fillore dhe ajo e ciklit të lartë kanë të njëjtin plan të obligueshëm – Planin Mësimor të Cyrihut 21. Në të janë përcaktuar kompetencat për arritjen e të cilave punohet në kopshtin e fëmijëve. Në këtë plan merren parasysh njohuritë e fundit mbi zhvillimin dhe të mësuarit e fëmijëve.

Loja ka një rëndësi të madhe dhe është pjesë përbërëse e mësimit. Kur fëmijët luajnë, ata edhe mësojnë njëkohësisht. Fëmijët e moshës më të re mësojnë duke soditur, imituar, bashkëpunuar, modeluar apo biseduar. Atyre ju pëlqen t'i provojnë mundësitë e tyre dhe t'i zgjerojnë ato. Për fëmijët loja dhe mësimi janë një e vetme. Në rrjedhën e tri deri katër viteve të para të shkollimit ndryshon edhe të menduarit dhe të mësuarit e fëmijëve. Ata mund të përqendrohen gjithnjë e më mirë në përmbajtjet mësimore që iu ofrohen nga të tjerët dhe mësojnë gjithnjë e më sistematikisht: kështu pikë-rëndesa e të mësuarit bartet në të mësuarit në lëmi, si në: gjuhë, matematikë apo art figurativ.

Gjuha e të mësuarit në kopshte është parimisht dialekti zviceran i gjermanishtes. Përdorimi i gjermanishtes letrare është i mundur në situata të caktuara.

Vrojtimi dhe vlerësimi në kopshtin e fëmijëve

Vlerësimi i nxënëses apo i nxënësit bëhet në një vlerësim të përgjithshëm. Bazë për këtë janë kompetencat e përshkruara në Planin Mësimor të Cyrihut 21. Edukatorët apo edukatorët e kopshtit e vlerësojnë fëmijën në bazë të gjendjes së zhvillimit, të njohurive, të



mundësive dhe të vullnetit të tij. Këto vrojtime dhe ky vlerësim janë bazë për vendimet e ardhshme pedagogjike, për bashkëpunimin me personat profesionistë (pedagoge/ë të veçantë, logopedë/ë etj.) dhe me prindërit. Vlerësimi i përgjithshëm e bën të qartë se si do të zhvillohet një fëmijë i caktuar. Ky vlerësim i komunikohet fëmijës dhe prindërve apo të autorizuarve për edukim. Edukatorja apo edukatori i kopshtit i fton prindërit në dy biseda gjatë vitit. Nga pjesëmarrja në bisedën e dytë prindërit mund të heqin dorë, nëse me këtë pajtohet edukatorja apo edukatori.

Pas bisedës, prindërit nënshkruajnë një formular, i cili dëshmon mbajtjen e bisedës. Po që se prindërit heqin dorë nga pjesëmarrja në bisedë, këtë e vërtetojnë gjithashtu përmes nënshkrimit në formular. Formularët ruhen në një dosje të veçantë, e cila ju jepet prindërve në fund të vitit shkollor, ngjashëm siç jepen dëftesat në shkollën fillore.

Tërheqja e obligimit shkollor

Tërheqja e obligimit shkollor (hyrjes në kopsht) është e mundur në raste të caktuara dhe atë në rastet kur për një fëmijë pritet të ketë vështirësi, të cilat nuk do të mund të kapërcehen edhe përkundër përdorimit të masave të veçanta. Në raste të rralla tërheqja mund të ndodhë edhe gjatë vitit shkollor. Kërkesa për këtë mund të bëhet si nga prindërit, ashtu edhe nga edukatorja apo edukatori i kopshtit. Vendimi i mbetet Komisionit Shkollor ("Schulpflege"). Në rast se prindërit nuk pajtohen me vendimin, mund të ushtrojnë ankesë në Këshillin e Qarkut ("Bezirksrat")

Kalimi në shkollën fillore

Kopshti i fëmijëve zgjat sipas rregullit dy vjet. Kapërcimi në shkollën fillore ndodh kryesisht në mënyrë të vetvetishme. Bazën për kapërcim e përbëjnë të ashtuquajturat pikat orientuese në Planin Mësimor. Ato tregojnë se në cilat kompetenca punohet në kopshtin e fëmijëve. Por, nuk është e domosdoshme që fëmijët me kapërcimin në shkollën fillore t'i zotërojnë të gjitha kompetencat e përshkruara. Tek në fund të klasës së dytë duhet që nxënëset apo nxënësit t'i arrijnë kompetencat themelore të përcaktuara në Planin Mësimor.

Në rast të vështirësive apo të vonesave në zhvillim duhet të sqarohet se a janë të domosdoshme te nxënëset apo nxënës të caktuar masat e veçanta. Për këtë vendosin mësueset dhe mësuesit së bashku me prindërit. Për këtë procedurë konsensuale ekziston një instrument special që quhet "Bisedë për përcaktimin e gjendjes në shkollë" ("Schulishes Standortgespräch"). Nëse në këtë bisedë nuk arrihet ujd, vendos Komisioni Shkollor ("Schulpflege"), vendim ndaj të cili mund të ushtrohet ankesë në Këshillin e Qarkut ("Bezirksrat").

Mungesat, dispenzimi dhe ditët xhokerë

Ndjekja e mësimit në kopsht është e obligueshme. Të gjitha rregulloret e Shkollës Publike mbi mungesat, dispenzimin dhe ditët xhokerë vlejnë edhe për kopshtin e fëmijëve. Konkretisht kjo do të thotë se nëse një fëmijë është i sëmurë dhe duhet të qëndrojë në shtëpi, duhet të informohet edukatorja apo edukatori.

Nëse dihet paraprakisht mungesat, duhet që të parashtrahet kërkesë për dispenzim në udhëheqjen e shkollës. Për një dispenzim duhet të ekzistojnë arsye të forta, si për shembull ndonjë ngjarje e veçantë në sferën personale, ditë të rëndësishme festive, takime të



veçanta të karakterit religjioz apo edhe sëmundje ngjitëse në rrethin personal të fëmijës. Udhëheqja e shkollës duhet që me rastin e vendimit për dhënien e ditëve të lira shkollore të marrë parasysh rrethanat personale, familjare dhe ato shkollore.

Secila nxënëse dhe secili nxënës ka të drejtë në të ashtuquajturat ditët xhokerë, do me thënë ka të drejtë të mungojë në mësim pa bërë kërkesë për dispensim. Prindërit ia bëjnë me dije paraprakisht edukatores/ edukatorit se kur dëshirojnë t'i shfrytëzojnë ditët xhokerë. Ditët e pashfrytëzuara gjatë vitit shkollor sipas rregullit nuk mund të shfrytëzohen më; prindërit informohen nga shkolla mbi rregullat e caktuara nëpër komuna.

Prindërit kanë të drejta dhe obligime

Në Ligjin mbi Shkollën Publike janë rregulluar qartë disa prej të drejtave dhe obligimeve të prindërve. Prindërit kanë të drejtë të informohen me kohë mbi çështjet organizative shkollore siç janë për shembull: caktimi fëmijëve në klasa, vendi i mbajtjes së mësimit, kohët e mbajtjes së mësimit dhe ngjarjet shkollore. Edukatorja apo edukatori duhet të informojë rregullisht mbi zhvillimet në kopshtin e fëmijëve.

Në raste të caktuara edukatorja apo edukatori dhe prindërit duhet të informohen reciprokisht, nëse p.sh. te një fëmijë paraqiten vështirësi, nëse ndodhin ngjarje të veçanta ose nëse në rezultatet e fëmijës apo në sjelljen e tij konstatohet diç e pazakonshme.

Prindërit në shkollë kanë të drejta individuale dhe të përgjithshme të bashkëpunimit. Mendimi i prindërve merret parasysh kur për shembull merren vendime mbi vazhdimin e mëtejshmë të shkollimit (Kalimi në shkollën filllore), vendime në sferën e pedagogjisë së veçantë (Biseda mbi përcaktimin e gjendjes në shkollë, (një procedurë konsensuale)) ose në rastet kur merren vendime për çështje disiplinore. Të drejtat e përgjithshme të bashkëpunimit, siç është e drejta e bashkëveprimit në Këshillin e Prindërve ("Elternrat") apo në programin shkollor, janë me vetë dëshirë dhe përcaktohen në statusin organizativ të komunës.

Ndjekja e kopshtit të fëmijëve është pa pagesë. Kjo e drejtë vlen në vendbanim. Nëse fëmija gjatë ditës nuk jeton në vendbanim, por, për shembull, në një familje ditore, atëherë kërkesa për ndjekje pa pagesë të kopshtit mund të bëhet edhe në vendqëndrimin faktik të fëmijës. Në rast se ekzistojnë arsye të forta, prindërit kanë mundësinë të bëjnë kërkesë në Komisionin Shkollor ("Schulpflege") për vijimin e kopshtit të fëmijës së tyre edhe në ndonjë komunë tjetër. Komuna gjegjëse vendos për një kërkesë të tillë dhe eventualisht mund të caktojë edhe një pagesë për vijimin e kopshtit. Për sjelljen e vendimeve të tilla në raste të caktuara, si për shembull në rast se kapërcimi i rrugës është me rreziqe apo rruga gjer në kopsht është e largët, komunat mund të merren vesh mes vete.

Për prindërit apo për personat e tjerë të cilëve iu janë besuar nxënëset dhe nxënësit, Ligji mbi Shkollën Publike parasheh edhe obligime. Ata mbajnë për shembull përgjegjësinë e ndjekjes së rregullt dhe në gjendje të çlodhur të kopshtit. Ata janë përgjegjës edhe për atë që fëmijët në mësim apo për raste të veçanta (shëtitjet etj.) të jenë të përgatitur në mënyrë adekuate.



Rruga për në shkollë

Përgjegjësia për rrugën e fëmijës për në shkollë është e prindërve. Parimisht fëmijët, pas një kohe përshtatjeje, do të duhej që rrugën për në shkollë ta përballonin vetë. Nëse rruga është e gjatë apo e rrezikshme, Komisioni Shkollor urdhëron marrjen e masave të posaçme, siç janë për shembull shërbimi i përcjelljes apo ngritja e një shërbimi patrullimi me shpenzimet e komunës.

Kohët bllok dhe orari i mësimit

Në tërë shkollën publike vlejnë kohët bllok. Komunitat janë të obliguara që mësimin apo ndonjë formë të përkujdesjes ta organizojnë gjatë tërë paradites nga ora 8.00 deri në ora 12.00. Për shkaqe organizative është e mundur që koha e mësimit apo e përkujdesjes të shkurtohet maksimalisht për 20 minuta për çdo paradite.

Një veçanti e kopshtit të fëmijëve është koha e pritjes, që mundëson ardhjen individuale të nxënësve dhe të nxënësve. Kjo kohë e vetë caktohet në mësimin që qendron në dispozicion çdo fëmije. Edukatorja apo edukatori mbarëshkon orën mësimore në këtë kohë individualisht dhe në përshtatje grupit të fëmijëve.

Kohët e obligueshme të mësimit janë përcaktuar me orarin e mësimit të Planit Mësimor të Cyrhut 21:

Viti i1-rë i kopshtit: 20 leksione javore; mësimi paradite sipas kohëve bllok.

Viti i 2-të i kopshtit: 24 leksione javore; mësimi paradite sipas kohëve bllok dhe në dy pasdite.

Strukturat ditore

Komunitat shkollore janë të obliguara që sipas nevojës të ofrojnë shërbim përkujdesjeje qoftë në drekë, pasdite (deri në ora 18.00) apo në rastin më të mirë edhe në mëngjes (nga ora 7.30) para fillimit të kohës bllok. Përkujdesja jashtë kohëve bllok është me pagesë. Informacionet e nevojshme për ofertat gjegjëse prindërit i marrin nga administrata shkollore apo nga mësimdhënësit.